



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

PROVIMI ME ZGJEDHJE I MATURËS SHTETËRORE

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

Lënda: Filozofi

Udhëzime të përgjithshme

- Testi përmban në total 40 pikë.
- Testi ka 20 pyetje: 10 me zgjedhje dhe 10 me zhvillim.
- Për pyetjet me zgjedhje përgjigjja e saktë vlerësohet me një pikë.
- Për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta.

• **Pyetjet me zgjedhje**

Numri i Pyetjes	1	2	4	6	8	12	15	16	18	20
Përgjigja e saktë	A	B	A	B	A	A	A	B	C	A

• **Pyetjet me zhvillim**

Shënim:

- Në skemën e vlerësimit të testit, për pyetjet me zhvillim janë dhënë modele përgjigjesh të sakta. Nxënësi do të marrë pikët e merituar edhe nëse ai ka dhënë përgjigje me fjalë të tjera por që janë brenda kontekstit të përgjigjes së saktë.
- Në pyetjet me zhvillim, ku kërkohen dy, tre apo katër nga të gjitha përgjigjet e sakta të mundshme, në rast se nxënësi ka dhënë aq përgjigje të sakta sa i kërkohen nga pyetja, atëherë atij do t'i jepen të gjitha pikët maksimale me të cilat është vlerësuar pyetja.
- Nxënësi do të marrë aq pikë sa është vlerësuar pyetja edhe në rast se ai ka dhënë më shumë përgjigje të sakta nga sa i kërkohen.
- Nxënësi merr pikë duke dhënë përgjigje sipas formimit të tij edhe nga lëndët e tjera. Kalimi nga njëra pikë te tjetra e një problemi nuk e ndëshkon në pikëzim, pasi ato lidhen me njëri-tjetrin.

3. Platoni

Model përgjigjeje:

a) remineshenca

- shpirti ynë ka ekzistuar para se të shfaqej në trup
- shpirti ynë ka njohur idetë në unitetin e tyre
- njohja përmbahet në shpirt
- në shpirt ruhet kujtimi i ideve
- të njohësh do të thotë të kujtoshbota shqisore na ngacmon për atë që shpirti ynë e përmban si dije të vërtetë

b) miti

- nuk vjen nga tradita popullore
- i merr nga feja orfike
- i krijon
- është tregim metaforik
- është tregim simbolik

-me figurat letrare të mitit e vërteta filozofike demonstroi bukurinë e saj

5. Model përgjigjeje:

- intuitës spontane të së vërtetës (aponinë.)
- intuitën e gjërave shqisore
- intuitës së refleksionit
- pasionit
- ndijimit
- ataraksinë.

- **3 pikë** Nëse shkruan tre nga llojet e ndryshme të dëshmive nga Kanonika e Epikurit
- **OSE**
- **2 pikë** Nëse shkruan dy nga llojet e ndryshme të dëshmive nga Kanonika e Epikurit
- **1 pikë** Nëse shkruan një nga llojet e ndryshme të dëshmive nga Kanonika e Epikurit
- **0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

7. Model përgjigjeje:

- a) intelektu i përgatitur
- b) intelektu në veprim
- c) intelektu që vjen nga jashtë.

3 pikë Nëse shkruan saktë korespondencën e secilës shkallë të njohjes të Avicenës të ndara sipas kërkesës a, b, c

OSE

2 pikë Nëse shkruan saktë korespondencën e dy prej shkallëve të njohjes të Avicenës

1 pikë Nëse shkruan saktë korespondencën e një prej shkallëve të njohjes të Avicenës

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

9. Model përgjigjeje:

- a)
 1. bazohet te Boeci
 2. është shkencë që nuk bazohet te vetë gjërat, por te fjalët që tregonin kuptimin e gjërave
 3. nuk na shpie te njohja e drejtpërdrejtë e sendeve
 4. dialektika interesohet për njohjen e gjërave
 5. mësimi i dialektikës është i thjeshtë: nis me termat jo kompleksë, pastaj me termat kompleksë, pra pohimet logjike dhe silogjizmin kategorik dhe gjymimet dhe silogjizmin hipotetik dhe përcaktimet dhe ndarjet.
- b)
 1. te nocionet filozofike gjeti një imazh të realitetit hyjnor
 2. duhej ta mendonte realitetin hyjnor përmes ngjashmërive

2 pikë Nëse shpjegon dialektikën e filozofisë së Pjer Abelard dhe metodën e tij.

OSE

1 pikë Nëse shpjegon dialektikën e filozofisë së Pjer Abelard

1 pikë Nëse shpjegon metodën e tij e filozofisë së Pjer Abelard

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

10. Model përgjigjeje:

- a) mënjanohej idetë e dyshimta (pranohet e vërtetë ajo që paraqitet e qartë)
- b) copëtohet problemi i vështirë në probleme më të thjeshta
- c) kalohet nga çështjet më të thjeshta në më të ndërlikuarat
- d) lidhja e çështje në dije tërësore dhe sa më harmonike.

- **3 pikë** Nëse shkruan tre elemente nga dyshimi metodik i Dekartit
- OSE**
- **2 pikë** Nëse shkruan dy elemente nga dyshimi metodik i Dekartit
- **1 pikë** Nëse shkruan një element nga dyshimi metodik i Dekartit
- **0 pikë** Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

11. Model përgjigjeje:

- a) burojnë nga antropocentrizmi ynë (prirja që ta shikojmë realitetin sipas masës njerëzore).
- b) paragjykimet dhe pasionet individuale (rezultat i edukimit dhe zakoneve tona).
- c) gabimet nga teoritë aristoteliane dhe skolastikës.

3 pikë Nëse identifikon thelbin e idhujve të analizuar nga Frensis Bekon sipas renditjes në kërkesë
OSE

2 pikë Nëse identifikon thelbin e dy idhujve të analizuar nga Frensis Bekon.

1 pikë Nëse identifikon një idhull të analizuar nga Frensis Bekon.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

13. Model përgjigjeje:

- a) shoqëria e kohës së tij mund të jepte një rend të sigurtë
- b) ligjet e shkencave matematike mund të shpjegojnë edhe shoqërinë
- c) e quan sociologjinë fizikë sociale
- d) sociologjia studion në mënyrë shkencore shoqërinë
- e) zëvendëson shpjegimet metafizike
- f) sociologjia duhet të ndjekë metodën historike
- g) sociologjia vendoset në majë të hierarkisë së shkencave
- h) sociologjia udhëzon shkencat e tjera në shërbim të njeriut
- i) sociologjia është shkencë e zhvilluar si sintezë e shkencave të tjera
- j) sociologjia mund të bashkojë metodat e shkencave të tjera

3 pikë Nëse shkruan tre tre aspekte nga shpjegimi që bën Konti për shfaqjen e sociologjisë
OSE

2 pikë Nëse shkruan dy aspekte nga shpjegimi që bën Konti për shfaqjen e sociologjisë

1 pikë Nëse shkruan një aspekt nga shpjegimi që bën Konti për shfaqjen e sociologjisë

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

14. Model përgjigjeje:

- a) arsye të kulluar
- b) arsyeja njerëzore
- c) e drejta

3 pikë Nëse shkruan saktë emërtimet e ideve në filozofinë e Kantit të ndara sipas kërkesës a, b, c
OSE

2 pikë Nëse shkruan saktë dy emërtime tw tilla

1 pikë Nëse shkruan saktë një emërtim tw tillw

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare

17. Model përgjigjeje:

- a) procedurë analize e proceseve mendore
- b) metodë e bazuar mbi këtë analizë për trajtimin e çrregullimeve neurotike
- c) seri konceptesh psikologjike (disipinë e re shkencore)

3 pikë Nëse shkruan tre aspekte të rëndësishëm të psikoanalizës.
OSE

2 pikë Nëse shkruan dy aspekte të rëndësishëm të psikoanalizës.

1 pikë Nëse shkruan një aspekt të rëndësishëm të psikoanalizës.

0 pikë Nëse përgjigjet gabim **OSE** nuk përgjigjet fare.

19. Model përgjigjeje:

- a) ideja për lirinë optimiste;
- b) fati është në duart e njeriut;

c) e zgjedh fatin përmes angazhimit të tij;

d) brenda kushteve historiko-sociale, njeriu mbetet i lirë(liria mbetet e plotë)/situata nuk e përcakton veprimin;

e) veprimi, angazhimi i japin kuptim situatës dhe bëjnë të mundur kapërcimin e saj.